

PHILIPS

AVENT

SCF293



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme	3
Rrezik.....	3
Paralajmërim	3
Kujdes	4
Hyrje	6
Përshkrim i përgjithshëm.....	6
Për t'u pasur parasysh.....	7
Njohja me cilësimet.....	9
Përpara përdorimit të parë	10
Përgatitja për përdorim	12
Përgatitja për sterilizim.....	12
Montimi i sterilizuesit.....	12
Përdorimi i pajisjes.....	13
Sterilizimi	13
Auto – Sterilizim dhe tharje.....	14
Tharja.....	16
Pastrimi	17
Pastrimi i filtrit.....	18
Deskorjezimi	19
Porositja e aksesorëve.....	20
Riciklimi.....	20
Mbështetja.....	20
Zgjidhja e problemeve	21

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen, si dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos i zhytni kurrë bazën, kordonin elektrik apo spinën në ujë apo në ndonjë lëng tjetër.
- Mosndjekja e udhëzimeve për zhgëlqerëzimin mund të shkaktojë dëmtim të pariparueshëm.
- Për të shmangur rrezikun e goditjes elektrike, mos e çmontoni kurrë bazën.

Paralajmërim

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Kjo pajisje nuk duhet përdorur nga fëmijët. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë servisi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangen rreziqet.
- Pajisja nuk përmban pjesë të cilave mund t'u bëhen shërbime servisi. Mos provoni ta hapni, t'i bëni servis apo riparoni vetë pajisjen.

- Pajisja nxehet jashtëzakonisht shumë gjatë përdorimit dhe mund të shkaktojë djegie nëse preket.
- Tregoni kujdes ndaj avullit të nxehtë që del nga vrima e ajrimit në kapak ose kur hiqni kapakun. Avulli mund të shkaktojë djegie.
- Mos e prekni bazën, koshat dhe kapakun gjatë apo brenda një kohe të shkurtër pas përdorimit, sepse janë shumë të nxehta. Ngrijeni kapakun duke e mbajtur vetëm nga doreza.
- Mos e zhvendosni apo mos e hapni kurrë pajisjen kur është në përdorim ose kur uji në të është ende i nxehtë.
- Mos vendosni kurrë artikuj mbi pajisje gjatë kohës që është në përdorim.
- Përdorni vetëm ujë pa aditivë.
- Mos futni në pajisje zbardhues apo kimikate të tjera.
- Mos hidhni më shumë ujë seç tregohet në rezervuar ose më shumë se 130 ml ujë.
- Sterilizoni vetëm biberonët e foshnjave dhe artikuj të tjerë të përshtatshëm për këtë pajisje. Kontrolloni manualin e përdorimit për sendet që dëshironi të sterilizoni, për t'u siguruar që janë të përshtatshëm për këtë pajisje.
- Nëse doni ta ndaloni procesin, shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të fikur pajisjen.
- Kjo pajisje synohet vetëm për përdorim shtëpiak.
- Mos e keqpërdorni këtë pajisje për qëllime të tjera përveç përdorimit të synuar të saj, për të evituar lëndimin e mundshëm.

Kujdes

- Mos përdorni kurrë aksesore apo pjesë nga prodhues të tjerë apo që nuk rekomandohen specifikisht nga "Philips". Nëse përdorni aksesore apo pjesë të tilla, garancia juaj bëhet e pavlefshme.

- Mos e ekspozoni pajisjen ndaj nxehtësisë ekstreme apo dritës së drejtpërdrejtë të diellit.
- Lëreni gjithnjë pajisjen të ftohet përpara se ta zhvendosni apo ta vendosni në ruajtje. 
- Sipërfaqet e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.
- Mos sterilizoni artikuj shumë të vegjël që mund të dalin nga vrimat në fund të koshit.
- Mos vendosni kurrë artikuj direkt mbi elementin nxehës kur pajisja është e ndezur.
- Mos e përdorni pajisjen nëse është rrëzuar apo ka pësuar ndonjë dëmtim. Dërgojeni për riparim te një pikë servisi e autorizuar nga "Philips".
- Gjithmonë vendoseni dhe përdoreni pajisjen mbi një sipërfaqe të thatë, të qëndrueshme, të niveluar dhe horizontale.
- Mos e vendosni pajisjen mbi sipërfaqe të nxehta.
- Mos lejoni që kordoni elektrik të varet jashtë cepit të tavolinës apo të syprinës së banakut mbi të cilin ndodhet pajisja.
- Derdheni gjithmonë ujin e mbetur në pajisje pas përdorimit dhe kur pajisja të jetë ftohur.
- Fikni pajisjen dhe hiqeni atë nga priza përpara se të ndërroni aksesoret ose përpara se t'u afroheni pjesëve që lëvizin gjatë përdorimit.
- Kushtet e ambientit, si temperatura dhe lartësia, mund të ndikojnë në funksionimin e pajisjes.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët.
- Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse mbetet pa mbikëqyrje.


Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje "Philips" pajtohet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Hyrje


Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips", regjistrojeni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Përshkrim i përgjithshëm



A	Kapaku me mbërthim	J	Kapëset
B	Koshi i vogël	K	Kapaku i filtrit
C	Pllaka e poshtme për koshin e madh	L	Foleja e mbajtjes së kordonit
D	Koshi i madh me tabakanë e kullimit	M	Filtri
E	Treguesi i nivelit maksimal të ujit	N	Modaliteti "Sterilizim"
F	Elementi ngrohës me rezervuarin e ujit	O	Modaliteti "Auto"
G	Njësia bazë	P	Modaliteti "Tharje"
H	Kordoni elektrik	Q	Butoni i ndezjes/fikjes
I	Vrima e daljes së ajrit	R	Çelësi i kontrollit me dritat treguese të progresit


Për t'u pasur parasysh



- Mos hidhni ujë në vrimën e daljes së ajrit.



- Mos e zhytni njësinë bazë në ujë.




- Mos vendosni sende nën njësinë bazë gjatë përdorimit, p.sh. peshqirë, lecka pastrimi etj.



- Përdorni 130 ml ujë.




- Pastrojini përpara se t'i vendosni në pajisje.



- Zbërthejini tërësisht pjesët e shishes dhe vendosini në pajisje me grykën për poshtë për të parandaluar mbushjen e tyre me ujë.



- Derdhni ujin e mbetur nga koshi i madh pas çdo përdorimi.



- Pastrojeni filtrin çdo 4 javë.



- Pastroni çmërsin e pajisjes çdo 2 javë.

Njohja me cilësimet

Shënim: Pastrojini shishet dhe artikujt e tjerë përpara se t'i sterilizoni.

Vendosni në sterilizues vetëm artikuj të përshtatshëm për sterilizim. Mos sterilizoni artikuj të mbushur me lëng, si p.sh. lodra për zbutjen e dhimbjes së daljes së dhëmbëve që përmbajnë lëng ftohës.



Sterilizimi 	• Modaliteti "Sterilizim" shërben për sterilizimin e artikujve për foshnja. • Një cikël sterilizimi zgjat afro 10 minuta. • Ngrohja zgjat afro 4 minuta dhe sterilizimi zgjat afro 6 minuta. • Sigurohuni të hidhni saktësisht 130 ml ujë të distiluar drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit në bazë.
Automatik 	• Modaliteti "Auto" shërben për sterilizimin dhe tharjen në të njëjtën kohë të artikujve për foshnja. • Një cikël automatik zgjat afërsisht 40 minuta. • Kur përdorni modalitetin "Auto" pajisja nis fillimisht sterilizimin dhe më pas tharja fillon automatikisht. Cikli i sterilizimit zgjat afërsisht 10 minuta dhe cikli i tharjes zgjat afërsisht 30 minuta. • Sigurohuni të hidhni saktësisht 130 ml ujë të distiluar drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit në bazë.
Tharja 	• Modaliteti "Tharje" shërben për tharjen e artikujve të foshnjave. • Një cikël tharjeje zgjat afro 30 minuta. • Kur thani artikujt e foshnjave, mos shtoni ujë në rezervuarin e ujit në bazë.

Përpara përdorimit të parë


Kur e përdorni pajisjen për herë të parë, ju këshillojmë ta lini të kryejë një proces sterilizimi me kosha bosh.

- 1 Përdorni një shishe të pastër për foshnja dhe hidhni saktësisht 130 ml ujë të distiluar drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit në bazë.


Këshillë: Kjo pajisje është krijuar për punë me ujë rubineti. Nëse banoni në zona me ujë të rëndë, pajisja mund të vishet shpejt me çmërs. Ndaj rekomandohet të përdorni ujë pa minerale, si p.sh. të distiluar apo të demineralizuar për të zgjatur jetëgjatësinë e pajisjes. Për më shumë informacion rreth bigorrit, shihni pjesën "Heqja e bigorrit".




- 2 Vendosni koshin e madh në bazë.




- 3 Vendosni pllakën e poshtme në koshin e madh.




- 4 Vendosni koshin e vogël në koshin e madh.



5 Vendosi kapakun mbi koshin e vogël.




6 Futeni spinën në prizë.



7 Kalojeni butonin e ndezjes/fikjes në modalitetin "Sterilize". Pastaj shtypeni për të ndezur pajisjen.

Kujdes: Baza, koshat dhe kapaku nxehen gjatë përdorimit ose për pak kohë pas përdorimit.

- Të gjitha dritat treguese të ecursisë pulsojnë për të treguar se pajisja po sterilizon.
- Kur përfundon procesi i sterilizimit, dritat fiken dhe pajisja fiket automatikisht.
- Butonin e ndezjes/fikjes mund ta kaloni në modalitetin "Dry" për ta tharë pajisjen. Duhet afro 30 minuta për të kryer ciklin e tharjes.



8 Pasi pajisja të jetë ftohur tërësisht, hiqini kapakun, koshin e vogël, pllakën e poshtme, koshin e madh dhe fshijini derisa të thahen.

Shënim: Kur hiqni koshin e madh nga baza, kini parasysh ujin e mbetur në kolektorin e bazës.

9 Lëreni pajisjen të ftohet tërësisht për rreth 10 minuta përpara se ta përdorni sërish.

Shënim: Pajisja nuk punon për 10 minuta pas një cikli sterilizimi. Duhet të ftohet përpara.

Përgatitja për përdorim


Përgatitja për sterilizim

Përpara se t'i vendosni artikujt për sterilizim në sterilizues, pastrojini një herë mirë në enëlarëse ose me dorë me ujë të ngrohtë dhe detergjent lëng për enët.


Montimi i sterilizuesit

Ka disa mënyra për ta montuar sterilizuesin.


- 1 Me vetëm koshin e vogël në bazë për të sterilizuar artikujt të vegjël si p.sh. biberonët qetësues.



- 2 Me vetëm koshin e madh në bazë për të sterilizuar artikujt mesatarë si p.sh. pompa gjiri, pjata bebesh ose mjete ngrënieje për bebe.




- 3 Me koshin e madh dhe të voglin në bazë për të sterilizuar deri në gjashtë shishe 330 ml. Vendosini shishet përmbys në koshin e madh dhe vendosini kapakët sferikë të shisheve, unazat mbërthyes dhe biberonët në koshin e vogël.



Shënim: Kur e mbushni koshin e vogël, vëriini unazat mbërthyes në fund, vendosini biberonët dhe kapakët e shisheve të lirshme mbi unazat mbërthyes.


Shënim: Sigurohuni që të gjitha pjesët për t'u sterilizuar të zbërthehen tërësisht dhe të vendosen në kosh me pjesët e hapur për poshtë, për të shmangur mbushjen e tyre me ujë.




Sterilizimi

Pastrimi i kujdesshëm dhe pa kimikate i sterilizuesit i mban artikujt sterilë për deri në 24 orë me kapakun të vendosur. Pas sterilizimit uji i mbetur në artikujt e foshnjës është steril dhe nuk mbledh mikrobe.

- 1 Hidhni ujë drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit të bazës (shihni pjesën "Përpara përdorimit të parë").
- 2 Montojeni sterilizuesin (shihni pjesën "Montimi i sterilizuesit") dhe vendosni brenda artikujt për t'u sterilizuar.
- 3 Vendosni kapakun mbi koshin e vogël ose të madh.



- 4 Futeni spinën në prizë.




- 5 Kalojeni butonin e ndezjes/fikjes në modalitetin "Sterilize". Pastaj shtypeni për të ndezur pajisjen.

Kujdes: Baza, koshat dhe kapaku nxehen gjatë përdorimit ose për pak kohë pas përdorimit.

Shënim: Mund ta fikni pajisjen duke shtypur butonin e fikjes.

- Të gjitha dritat treguese të ecursisë pulsojnë për të treguar se pajisja po sterilizon.
- Kur përfundon procesi i sterilizimit, dritat fiken dhe pajisja fiket automatikisht.



- 6 Hiqni kapakun.

Prisni derisa pajisja të jetë ftohur dhe më pas hiqni kapakun.
Bëni kujdes. Mund të dalë avull i nxehtë nga sterilizuesi.

- 7 Hiqni shishet dhe artikujt e tjerë nga koshi. Përdorni mashat për heqjen e artikujve të vegjël.

Bëni kujdes. Artikujt e sterilizuar mund të jenë ende të nxehtë.

Shënim: Sigurohuni t'i lani mirë duart përpara se të prekni artikujt e sterilizuar.

- 8 Hiqeni pajisjen nga priza dhe prisni derisa të jetë ftohur tërësisht.

- 9 Hiqini koshin e vogël dhe koshin e madh.

Shënim: Kur hiqni koshin e madh, kini parasysh ujin e mbetur në kolektorin e bazës.

Shënim: Kolektori është menduar për mbledhjen e qumështit apo të mbetjeve ushqimore dhe për të penguar vajtjen e tyre në rezervuarin e ujit të bazës. Kjo është për të optimizuar efikasitetin e sterilizimit dhe për të lehtësuar pastrimin e elementit ngrohës.

- 10 Shkëputeni pllakën e poshtme nga koshi i madh. Derdhni ujin e mbetur nga kolektori i koshit të madh dhe pastrojeni (shihni "Pastrimi").

- 11 Derdhni ujin e mbetur nga rezervuari i ujit dhe fshijeni derisa të thahet.

Shënim: Pajisja nuk punon për 10 minuta pas një cikli sterilizimi. Duhet të ftohet përpara.

Auto – Sterilizim dhe tharje


- 1 Hidhni ujë drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit të bazës (shihni pjesën "Përpara përdorimit të parë").

- 2 Montojeni sterilizuesin (shihni pjesën "Montimi i sterilizuesit") dhe vendosni brenda artikujt për t'u sterilizuar.


Shënim: Sigurohuni që të gjithë artikujt të jenë zbërthyer tërësisht dhe vendosur në kosh me pjesët e hapura për poshtë, për tharje efikase.

Bëni kujdes. Kur fillon tharja, sterilizuesi çliron avull të nxehtë.

- 3 Vendosni kapakun mbi koshin e vogël ose të madh.




- 4 Futeni spinën në prizë.



**5 Kalojeni butonin e ndezjes/fikjes në modalitetin "Auto".
Pastaj shtypeni për të ndezur pajisjen.**

- Pajisja fillon sterilizimin përpara. Të gjitha dritat treguese të ecurisë pulsojnë për të treguar se pajisja po sterilizon.
- Pas kësaj fillon automatikisht tharja. Dritat treguese të ecurisë pulsojnë dhe fiken gradualisht për të treguar se pajisja po thahet.
- Kur përfundon i gjithë procesi, dritat fiken dhe pajisja fiket automatikisht.



Kujdes: Baza, koshat dhe kapaku nxehen gjatë përdorimit ose për pak kohë pas përdorimit.

6 Hiqni kapakun.

7 Hiqni shishet dhe artikujt e tjerë nga koshi. Përdorni mashat për heqjen e artikujve të vegjël.

Bëni kujdes. Artikujt e sterilizuar mund të jenë ende të nxehtë.

Shënim: Sigurohuni t'i lani mirë duart përpara se të prekni artikujt e sterilizuar.

Shënim: Rezultati i tharjes mund të variojë në varësi të temperaturës së ambientit, lagështisë së ambientit dhe ngarkimit të sterilizuesit. Nëse nevojitet, mund të kryeni edhe një cikël tjetër tharjeje.

8 Hiqeni pajisjen nga priza dhe prisni derisa të jetë ftohur tërësisht.

9 Hiqini koshin e vogël dhe koshin e madh.

Shënim: Kur hiqni koshin e madh, kini parasysh ujin e mbetur në kolektorin e bazës.

10 Shkëputeni pllakën e poshtme nga koshi i madh. Derdhni ujin e mbetur nga kolektori i koshit të madh dhe pastrojeni (shihni "Pastrimi").


Tharja

- 1 Montojeni sterilizuesin (shihni pjesën "Montimi i sterilizuesit") dhe vendosni brenda artikujt për t'u tharë.


Shënim: Sigurohuni që të gjithë artikujt të jenë zbërthyer tërësisht dhe vendosur në kosh me pjesët e hapura për poshtë, për tharje efektive.

Bëni kujdes. Kur fillon tharja, sterilizuesi çliron avull të nxehtë.

- 2 Vendosni kapakun mbi koshin e vogël ose të madh.




- 3 Futeni spinën në prizë.



- 4 Kalojeni butonin e ndezjes/fikjes në modalitetin "Dry". Pastaj shtypeni për të ndezur pajisjen.

- Tharja fillon pas rreth 30 sekondave. Pajisja ngrohet për të krijuar ajër të ngrohtë për tharjen e artikujve.
- Dritat treguese të ecurisë pulsojnë dhe fiken gradualisht për të treguar se pajisja po thahet.
- Kur përfundon procesi i tharjes, dritat fiken dhe pajisja fiket automatikisht.



Kujdes: Baza, koshat dhe kapaku nxehen gjatë përdorimit ose për pak kohë pas përdorimit.

- 5 Hiqni kapakun.
- 6 Hiqni shishet dhe artikujt e tjerë nga koshi. Përdorni mashat për heqjen e artikujve të vegjël.

Bëni kujdes. Artikujt e tharë mund të jenë ende të nxehtë.

Shënim: Sigurohuni t'i lani mirë duart përpara se të prekni artikujt e tharë.

Shënim: Rezultati i tharjes mund të variojë në varësi të temperaturës së ambientit, lagështisë së ambientit dhe ngarkimit të sterilizuesit. Nëse nevojitet, mund të kryeni edhe një cikël tjetër tharjeje.

- 7 Hiqeni pajisjen nga priza dhe prisni derisa të jetë ftohur tërësisht.

Pastrimi



Mos përdorni detergjentë gërryes apo agresivë (p.sh. zbardhues) apo leckë të ashpër/tel për pastrimin e kësaj pajisjeje.

Mos e zhysni kurrë bazën dhe kordonin elektrik në ujë apo në lëngje të tjera.

Shënim: Sterilizuesi nuk bën për t'u larë në enëlarëse. Koshat, pllaka fundore dhe kapaku mund të lahen me ujë të ngrohtë dhe detergjent lëng për enë.

- 1 Hiqeni gjithnjë pajisjen nga priza dhe lëreni të ftohet përpara se ta pastroni.
- 2 Pastrojeni bazën me një leckë të lagur.
- 3 Shkëputeni pllakën e poshtme nga koshi i madh.
Derdhni ujin e mbetur nga kolektori i koshit të madh.

**Shënim: Uji mblidhet në kolektorin e koshit të madh pas çdo cikli sterilizimi.
Derdhni ujin e mbetur nga koshi i madh pas çdo përdorimi.**





- 4 Pastrojeni kapakun, koshin e vogël, pllakën fundore dhe koshin e madh në ujë të ngrohtë me pak detergjent lëng për enë.


Shënim: Pas pastrimit, ruajeni sterilizuesin në një vend të pastër dhe të thatë.

Pastrimi i filtrit

1 Shkëputeni kapakun e filtrit nga baza.







2 Hiqeni filtrin dhe pastrojeni nën ujë rubineti.



3 Lëreni filtrin të thahet tërësisht në ajër. Vendoseni sërish në bazë dhe mbylleni kapakun e filtrit.

Shënim: Pastrojeni filtrin të paktën çdo 4 javë për t'u siguruar që të vijojë të filtrojë me efikasitet.




Deskorjezimi

Procesi i sterilizimit është tejet i rëndësishëm për të garantuar standardet më higjienike për foshnjën tuaj. Depozitimet e bigorrit mund të ngadalësojnë ciklin e sterilizimit dhe madje edhe t'i cenojnë efikasitetin.


Bigorri është një depozitim i fortë dhe si shukumës. Në varësi të tipit të ujit në zonën tuaj, bigorri mund të ketë paraqitje të ndryshme nga pluhur i bardhë si bora deri në njolla si të kafenjta. Sa më i fortë uji, aq më shpejt grumbullohet bigorri. Ai grumbullohet në pajisje si depozitime minerale që përmban uji në gjendje natyrale, të cilat nuk avullojnë kur ky ngrohet. Ndonëse nuk është i dëmshëm në vetvete, nuk është diçka e këndshme për t'i parë dhe mund të pengojë funksionimin e pajisjeve apo t'u dëmtojë pjesët nëse lihet të grumbullohet.

Pastrojeni bigorrin e sterilizuesit të paktën çdo 2 javë për t'u siguruar që të punojë me efikasitet.


- 1 **Hidhni 12 ml uthull të bardhë (5 % acid acetik) dhe 120 ml ujë në rezervuarin e ujit.**




- 2 **Prisni 6 orë/gjithë natën ose derisa të jetë shpërbërë i gjithë çmërsi.**



- 3 **Zbrazeni rezervuarin e ujit dhe shpëlajeni mirë.**



- 4 Nëse shihni ende gjurmë bigorri, hiqini me sfungjer. Shpëlajeni sërish dhe fshijeni bazën me një leckë të njomë.



Shënim: Mund dhe të përdorni deskorjezues me bazë acidi citrik.

Shënim: Mos përdorni lloje të tjera zhgëlqerëzuesish.

Porositja e aksesorëve

Për të blerë aksesorë ose pjesë rezervë, vizitoni faqen **www.philips.com** ose shkoni te shitësi i "Philips". Gjithashtu mund të kontaktoni me Qendrën e Kujdesit për Klientin të "Philips" në vendin tuaj (shihni fletëpalosjen e garancisë në mbarë botën për të dhënat e kontaktit).

Riciklimi

Ky simbol do të thotë që produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.

Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.



Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni **www.philips.com/support**.

Shënim: Për performancë optimale, kësaj pajisjeje duhet t'i pastrohet çmërsi rregullisht. Nëse nuk e bëni këtë, pajisja mund të mos funksionojë më. Në këtë rast, riparimi NUK mbulohet nga garancia.

Shënim: Konsumi i energjisë (modaliteti i pritjes): <0,3 W (kohë deri në modalitetin automatik të pritjes: <1 min)

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Zgjidhja
Kur duhet ta pastroj sterilizuesin?	Kur e përdorni sterilizuesin mund të vini re se ka njolla të vogla nga të bardha dëborë deri në të kafenjta që shfaqen në pllakën ngrohëse. Kjo është shenjë se sterilizuesi duhet të pastrohet nga bigorri. Në çfarëdo rasti, sterilizuesi duhet të pastrohet nga bigorri të paktën çdo 4 javë për të garantuar që të vazhdojë të funksionojë me efikasitet.
Përse është kaq e shkurtër koha e sterilizimit?	Nuk keni shtuar ujë të mjaftueshëm për sterilizim. Hidhni saktësisht 130 ml ujë të distiluar drejtpërdrejt në rezervuarin e ujit në bazë.
Përse mbetet ende kaq shumë ujë në pllakën ngrohëse pas sterilizimit?	Pllaka ngrohëse mund të bllokohet nga bigorri. Sterilizuesi duhet të pastrohet nga bigorri të paktën çdo 2 javë. Shihni pjesën “Pastrimi i bigorrit”.
Përse ka një erë si të djegur dhe shenjë djegieje në bazë?	Mund të mos keni derdhur rregullisht ujin e mbetur nga kolektori i koshit të madh. Uji mblidhet në kolektorin e koshit të madh pas çdo cikli sterilizimi. Derdheni ujin e mbetur nga koshi i madh pas çdo përdorimi. 1 Shkëputeni pllakën e poshtme nga koshi i madh. Dërdhni ujin e mbetur nga kolektori i koshit të madh. 2 Pastrojini kapakun, koshin e vogël, pllakën fundore dhe koshin e madh në ujë të ngrohtë me pak detergjent lëng për enë. Artikujt mund të mos jenë pastruar mirë përpara sterilizimit. Përpara se t'i vendosni artikujt për sterilizim në sterilizues, pastrojini mirë në enëlarëse ose me dorë me ujë të ngrohtë dhe detergjent lëng për enët.

Problemi	Zgjidhja
Veshja po shqitet nga pllaka ngrohëse. A ndikon kjo në funksionim?	Kjo gjë nuk ndikon në funksionin e sterilizuesit. Sigurohuni që të mos përdorni asnjë solucion pastrimi gërryes ose abrazivë (p.sh. zbardhues) apo sfungjerë gërrisës për të pastruar pllakën ngrohëse. Shmangni derdhjen e ujit të ftohtë mbi pllakën e nxehtë menjëherë pas përdorimit, pasi mund të shkaktojë plasaritje për shkak të ftohjes së shpejtë të veshjes kundër ngjitjes.
Përse pushoi së punuari sterilizuesi?	Pllaka ngrohëse mund të bllokohet nga bigorri. Sterilizuesi duhet të pastrohet nga bigorri të paktën çdo 2 javë. Shihni pjesën “Pastrimi i bigorrit”.
Artikujt janë ende të lagur pas ciklit të tharjes.	Artikujt mund të jenë ende të lagur për disa arsye: • Temperatura e ambientit ose lagështia • Ngarkimi i sterilizuesit • Artikujt janë stivuar shumë pranë njëri-tjetrit Sigurohuni që përreth artikujve të qarkullojë ajër i nxehtë, për të siguruar tharje efektive. Nëse nevojitet, mund të kryeni edhe një cikël tjetër të plotë tharjeje.

